




| | | |
|--|----------------------------------|---|
| Komuna e Kërçovës Sektori i çështjeve financiare | Nr. 03-3345/1 (Numri Arkivor) | |
| HARTA E PROCESIT Përgatitja e Planit të Prokurimit Publik | Data: 27.12.2024 | |
| Obligim për zbatim: Kryetari i Komunës së Kërçovës Njësia për Prokurimet Publike | Versioni i dokumentit: | 2 |
| | Zbatimi nga: | 01.01.2025 |
| | Data e rishikimit të fundit: | |
| <u>Nënprocesi I:</u> Përgatitja e Planit të Prokurimit Publik <u>Nënprocesi II:</u> Sjellja e një plani <u>Nënprocesi III:</u> Zbatimi i Planit të Prokurimit Publik | Përgatiti |  (nënskrim) |
| | Lejoi: |  (nënskrim) |
| | Kryetari Komunës: |  (nënskrim) |



I. Qëllimi i procesit

Mënyra e përpilimit të Planit për Prokurime Publike

1. Komuna e Kërçovës miraton Planin për Prokurime Publike çdo vit deri më 31 janar të vitit aktual, ndërsa atë e përgatit Njësia për Prokurime Publike pranë Sektorit për çështje financiare.
2. Objekti i kësaj procedure është mënyra e përgatitjes së planit për prokurime publike.
3. Në Planin për Prokurime Publike parashikohen: objekti i prokurimit, mjetet e nevojshme, periudha e realizimit.
4. Plani për Prokurime Publike përpilohet duke përdorur të dhëna nga tre burime, dhe atë:
 - Metoda historike
 - Metoda sipas nevojës
 - Njoftimet nga sektorët
5. Kombinimi i këtyre tre metodave është mënyra me të cilën përgatitet Plani për Prokurime Publike në Komunën e Kërçovës.
6. Metoda historike përfshin: Plani për prokurime publike përpilohet çdo vit duke parashikuar prokurimet publike që janë të domosdoshme për funksionimin e Komunës, të cilat përsëriten dhe janë të nevojshme çdo vit.

7. Metoda sipas nevojës përfshin ato prokurime që sektorët dhe njësitë i propozojnë bazuar në nevoja të reja të prokurimeve publike për financimin e projekteve dhe programeve buxhetore për vitin e ardhshëm.
8. Një pjesë e prokurimeve publike paraqiten për realizim edhe gjatë vitit, por nuk janë të parashikuara me planin për prokurime publike, dhe ato janë rezultat i projekteve të fituara nga jashtë, nga thirrje publike nga nivele të tjera të pushtetit ose burime të tjera financimi.
9. Në përpilimin e planit për prokurime publike marrin pjesë të gjithë udhëheqësit e sektorëve dhe udhëheqësit e njësive në Komunën e Kërçovës.
10. Përveç prokurimeve publike që realizohen çdo vit, në planin për prokurime publike përfshihen edhe ato prokurime që dalin nga programet zhvillimore të miratuara nga këshilli, projektet nga programet vjetore dhe projektet që dalin nga sesionet e forumeve të mbajtura gjatë përgatitjes së Buxhetit dhe mënyra të tjera të prezantimit të Buxhetit si dhe projekte të fituara nga institucione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.
11. Sektorët dorëzojnë: vlerën e prokurimit që del nga projekti, lëndën e përllogaritjes dhe përllogaritje të tjera në varësi të llojit të prokurimit dhe i dorëzojnë te Njësia për Prokurime Publike.
12. Në bazë të burimeve të financimit të përcaktuara me Buxhetin e Komunës së Kërçovës dhe të dhënave nga mënyrat e lartpërmendura të përgatitjes së Buxhetit, i qasemi përgatitjes së Planit për Prokurime Publike.
13. Njësia për Prokurime Publike, Planin e përgatitur për prokurime publike e dorëzon për nënshkrim te Kryetari i komunës deri në fund të janarit të vitit aktual.
14. Plani për Prokurime Publike publikohet në faqen e internetit të Byrosë për Prokurime Publike dhe në faqen e internetit të Komunës së Kërçovës.
15. Njësia për prokurime publike mban evidencë dhe informon për prokurimet që duhet të publikohen.